



www.legjisllacioni.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 15

Tiranë – E hënë, 23 maj 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 980, datë 24.3.2015	3
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 3388, datë 15.10.2015	3
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 4761, datë 21.12.2015	3

**VENDIM****Nr. 980, datë 24.3.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. 6, datë 22.5.2014, ndaj z. Jak Zhupa, kryetar i Komunës Blinisht, qarku Lezhë, nr. prot. 231, datë 28.5.2014,

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi, në zbatim të nenit 146, pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm nr. 6, datë 22.5.2014, i dënimit me gjobë në vlerën 500.000 lekë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar dhe pranimin e vendimit përfundimtar.

**KRYEINSPEKTORI**  
**Ergys Agasi**

**VENDIM****Nr. 3388, datë 15.10.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar, me nr. 1, datë 1.8.2015 të ISHMP-së, Dega Rajonale Lezhë, ndaj subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Gjet Gjonaj”, protokolluar me nr. 2508, datë 5.8.2015,

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe

përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm nr. 1, datë 1.8.2015, i ISHMP-së, Dega Rajonale Lezhë, ndaj subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Gjet Gjonaj”, i dënimit me gjobë në vlerën 50.000 lekë, është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Rrëzimin e ankimit të subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Gjet Gjonaj” dhe lënien në fuqi të vendimit përfundimtar nr. 1, datë 1.8.2015 të ISHMP-së, Dega Rajonale Lezhë.

**KRYEINSPEKTORI**  
**Ergys Agasi**

**VENDIM****Nr. 4761, datë 21.12.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar, me nr. 5, datë 10.3.2015 të ISHMP-së, Dega Rajonale Lezhë, ndaj subjektit/personit “Tonin Pjetri”, protokolluar me nr. 875, datë 19.3.2015,

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146 pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Vendimi i mësipërm nr. 5, datë 10.3.2015, të ISHMP-së, Dega Rajonale Lezhë, ndaj subjektit/personit “Tonin Pjetri”, i dënimit me gjobë në vlerën 100.000 lekë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit



VENDOSI:

Rrëzimin e ankimit të subjektit/personit “Tonin Pjetri” dhe lënien në fuqi të vendimit përfundimtar nr. 5, datë 10.3.2015 të ISHMP-së, Dega Rajonale Lezhë.

KRYEINSPEKTORI  
**Ergys Agasi**

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.